

Fuqizimi i Mbrojtjes nga Dhuna me Bazë Gjinore për Gratë LBQ¹ në Shqipëri

Mangësitë, sfidat dhe rekomandimet
politike për përgjigje gjithëpërfshirëse

Autorja:

Bojana Jovanovska,
Hulumtuese, eksperte për barazi gjinore dhe dhunë me bazë gjinore



Funded by
the European Union



¹Gratë LBQ është një term që përfshin gra lezbike, biseksuale dhe kuir, duke përfshirë gratë ciszhanre, transgjinore dhe interseksuale, si dhe të gjitha personat jobinare ose gjinorë-kuir në spektrin gjinor që identifikohen me një identitet LBQ.

Përmbledhje Ekzekutive

Në Shqipëri, gratë LBQ përballen çdo ditë me kërcënime ndaj dhunës dhe diskriminimit në një sistem që në mënyrë formale premtan mbrojtje, por që nuk i njeh dhe nuk u shërben nevojave të tyre specifike. Edhe pse kuadri ligjor dhe politik është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare për barazi gjinore dhe ndalim të diskriminimit, mekanizmat e zbatimit përjashtojnë realitetet e jetuara të grave LBQ.

Dhuna në partneritete të së njëjtës gjini nuk njihet zyrtarisht, duke çuar në mohimin e shërbimeve thelbësore dhe të të drejtave ligjore. Të mbijetuarat përballen me diskriminim nga anëtarët e familjes dhe institucionet, duke përjetuar praktika korrigjuese, nxjerrje të detyruar nga rrethi apo dhunë psikologjike, pa asnjë reagim institucional. Mungesa e strehëzave gjithëpërfshirëse, stafit të trajnuar dhe procedurave konfidenciale për raportim i lë të mbijetuarat pa rrugëzgjdhje, duke forcuar ciklin e padukshmërisë dhe dëmit.

Kjo përmbledhje politike adreson boshllëqet thelbësore dhe synon zhvillimin e një plani të veçantë që do të forcojë mbrojtjen, qasjen në drejtësi dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse për gratë.

Kjo përmbledhje mbështetet në gjetjet e raportit “Analiza mbi Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave LBQ në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi”, e cila kombinon rishikimin e dokumentacionit ligjor dhe politik, diskutimet në grupet fokale dhe një vlerësim të përputhshmërisë me Konventën e Stambollit.

Mbrojtje Ligjore pa Njohje

Kushtetuta e Shqipërisë dhe ligjet kundër diskriminimit e njohin orientimin seksual dhe identitetin gjinor si baza të mbrojtura, dhe Konventa e Stambollit është ratifikuar. Megjithatë, kuadri ligjor dhe politik kombëtar nuk i njeh marrëdhëniet e të njëjtës gjini dhe nuk adreson dhunën në partneritetet intime të së njëjtës gjini.

Kjo heshtje ligjore nënkupton që të mbijetuarat LBQ nuk mund të përfitojnë urdhra mbrojtjeje apo mbështetje emergjente në kushte të barabarta. Policia, punonjësit socialë dhe ofruesit e shëndetësisë veprojnë në bazë të ligjeve neutrale ndaj gjinisë, të cilat nuk përfshijnë format specifike të dhunës që përjetojnë gratë LBQ — nga praktikatat korrigjuese dhe shtrëngimi psikologjik, deri te përjashtimi nga strehëzat për shkak të identitetit të tyre.

Strategjitë kombëtare përmendin “ndërthurjen e formave të diskriminimit” (intersectionality), por nuk përmbajnë veprime të synuara dhe të financuara për gratë LBQ. Planet strategjike shpesh janë të paqarta dhe pa mekanizma për ndjekjen e zbatimit, ndërsa bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile mbetet informal, i udhëhequr nga donatorët dhe i financuar në mënyrë të pamjaftueshme.

Shërbime që Përjashtojnë në Mënyrë të Heshtur

Strehëzat e financuara nga shteti dhe shërbimet psikosociale nuk janë të përgatitura për të mbështetur të mbijetuarat LBQ. Ka pasur raste kur gratë janë refuzuar ose janë nxjerrë në pah në mënyrë të detyrues brenda strehëzave, duke u ekspozuar ndaj dëmeve të mëtejshme. Nuk ekzistojnë standarde shërbimi, mekanizma referimi apo struktura përgjegjësie që të garantojnë qasje të sigurt për gratë LBQ.

Punonjësit e shëndetësisë shpesh nuk kanë trajnim apo vetëdije mbi dhunën që lidhet me SOGIESC (orientimin seksual, identitetin gjinor, shprehjen gjinore dhe karakteristikat gjinore), dhe të mbijetuarat mund të dërgohen në terapi “konvertimi”, e cila nuk është e ndaluar në mënyrë të qartë me ligj. Mbështetja për shëndetin mendor është e kufizuar dhe të mbijetuarat duhet të përballen me sisteme armiqësore ose të patrajnuara për të marrë ndihmën e nevojshme. Shumica mbështeten te organizatat e shoqërisë civile, të cilat operojnë me mbështetje minimale dhe shpesh pa njohje zyrtare.

Padukshmëria në Sistemin e të Dhënave

Institucionet publike nuk mbledhin të dhëna mbi përvojat e grave LBQ. Pa të dhëna të ndara sipas orientimit seksual dhe identitetit gjinor, përmasat dhe natyra e dhunës mbeten të fshehura, dhe gratë LBQ mungojnë në raportet kombëtare, vlerësimet dhe vendimmarrjet për financim. Shoqëria civile mbetet burimi kryesor i të dhënave, por kontributet e saj rrallëherë përfshihen në kuadrot zyrtare të monitorimit.

Rekomandime për Mbrojtje Gjithëpërfshirëse

Për të mbyllur hendekun mes të drejtave në letër dhe mbrojtjes reale, Qeveria e Shqipërisë duhet të zbatojë reforma urgjente.

1. Reforma Ligjore dhe Politike

- Të ndryshohen ligjet dhe protokollet që trajtojnë dhunën me bazë gjinore për të përfshirë në mënyrë të qartë dhunën në partneritete të së njëjtës gjini. Të gjitha masat mbrojtëse, përfshirë urdhrat e ndalimit dhe ndalimet emergjente, duhet të jenë të aksesueshme pavarësisht nga statusi martesor apo bashkëjete-sa.
- Të miratohet Ligji për Partneritete të së Njëjtës Gjini për të siguruar njohje ligjore dhe mbrojtje të barabartë për familjet LBQ në kuadër të ligjeve për dhunën në familje, të drejtën e trashëgimisë dhe aksesin në shërbime.
- Të sigurohet që strategjitë kombëtare për barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore dhe të drejtat e personave LGBTI të përfshijnë masa specifike, me afate kohore dhe buxhet të dedikuar për gratë LBQ, me përgjegjësi të qarta institucionale dhe tregues për monitorim.
- Në periudhë afatgjatë, shteti duhet të garantojë barazi të plotë ligjore për çiftet e së njëjtës gjini duke hequr barrierat diskriminuese në ligjin familjar dhe politikat përkatëse.

2. Shërbime Gjithëpërfshirëse dhe të Aksesueshme

- Të gjitha strehëzat dhe shërbimet në raste krize duhet të jenë të detyruara të zbatojnë protokolle kundër diskriminimit dhe të adoptojnë procedura pranimit gjithëpërfshirëse, të përshtatura për nevojat e grave LBQ.
- Të krijohet të paktën një strehë dhe qendër mbështetëse e specializuar për personat LGBTIQ, e financuar plotësisht, që do të shërbejë si hapësirë e sigurt për ata që përjashtohen nga shërbimet e zakonshme.
- Shërbimet psikosociale dhe të shëndetit riprodhues, të bazuara në njohjen e traumës, duhet të zgjerojnë përfshirjen dhe të jenë të hapura për gratë LBQ.
- Praktikrat e “konvertimit” në kujdesin shëndetësor dhe në shërbimet sociale duhet të ndalohen në mënyrë eksplicite.

3. Kapacitet Institucional dhe Trajnim

- Të zhvillohen programe trajnimi të detyrueshme për oficerët e policisë, punonjësit socialë, prokurorët, gjyqtarët dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor, me fokus në qasje të ndjeshme ndaj SOGI-ESC dhe të bazuara në traumë për trajtimin e dhunës me bazë gjinore.
- Këto trajnime duhet të institucionalizohen përmes përfshirjes në programet e orientimit për sektorin publik dhe të lidhen me zhvillimin profesional dhe sistemet e vlerësimit të performancës.
- Të krijohen protokolle për referime të sigurt dhe konfidenciale ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike, për të garantuar një qasje të fokusuar te e mbijetuara ndaj mbështetjes.

4. Mbledhja e të Dhënave

- Të dhënat dhe gjetjet kërkimore të shoqërisë civile duhet të njihen në mënyrë formale dhe të integrohen në sistemet kombëtare të monitorimit dhe raportimit.
- Të zhvillohet një studim kombëtar mbi përhapjen e dhunës me bazë gjinore, me tregues specifikë për gratë LBQ dhe personat jo-binarë, dhe rezultatet të jenë të aksesueshme për publikun.

5. Partneritete dhe Ndërgjegjësim Publik

- Të krijohen dhe mbështeten në mënyrë formale partneritete afatgjata me organizatat e shoqërisë civile që mbështesin gratë LBQ, përmes financimit publik.
- Sistemet e referimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike duhet të koordinohen dhe të funksionalizohen për të garantuar ofrim shërbimesh gjithëpërfshirëse.
- Të zhvillohen fushata kombëtare ndërgjegjëse për të promovuar autonominë trupore, dinjitetin dhe diversitetin, si dhe për të reduktuar stigmatizimin shoqëror.
- Zyrtarët publikë dhe liderët politikë duhet të përballen me pasoja për gjuhën e urrejtjes dhe retorikën diskriminuese, përmes mekanizmave të përshtatshëm ligjorë dhe disiplinorë.

Thirrje për Veprim

Shqipëria duhet të përmbushë detyrimet e saj sipas Konventës së Stambollit duke garantuar mbrojtje për të gjitha gratë, përfshirë gratë LBQ, pa përjashtim. Të mbijetuarave nuk duhet t'u mohohet drejtësia apo siguria për shkak të padukshmërisë së marrëdhënieve të tyre apo stigmës që rrethon identitetet e tyre.

Bëjmë thirrje për bashkëpunim urgjent ndërministror mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Drejtësisë për të zbatuar politika strehimi gjithëpërfshirëse, për të ndaluar në mënyrë eksplicite praktikatat e konvertimit dhe për të njohur dhunën në partneritete intime të së njëjtës gjini.

Analiza “Analiza mbi Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave LBQ në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Serbi” përmban gjetjet e detajuara të kërkimit.

Informacion Kontakti

Elena Petrovska

elena@lgbti-era.org



Website

www.lgbti-era.org



Kjo Përmbledhje Politike është pjesë e projektit:

"Krijimi i Strategjive Kolektive për Mbrojtjen e Grave Lezbike nga Dhuna me Bazë Gjinore në Kosovë, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Shqipëri"*

"Ky projekt financohet nga EuroCentralAsian Lesbian Community dhe Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Shoqatës ERA LGBTI për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, e cila e zbaton projektin, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e EuroCentralAsian Lesbian Community apo të Bashkimit Evropian."**